



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

RELACION

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASEN DIANA MUÇAJ BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR

Spektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Diana Muçaj** më datë **10.10.2024**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", neni 24, "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.44, datë 15.12.2023", për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj:

JU RELATOJ:

Familja e **Znj. Diana Muçaj** me banim në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, e përbërë prej dy anëtarësh, kryefamiljari dhe bashkëshortja.

Znj. Diana Muçaj para dy muajëve ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në gjoks. Pas operacionit mjekët i kanë rekomanduar të vazhdojë terapinë me Kimio. Terapia është e kushtueshme ashtu si dhe operacioni që ka kryer. Bashkëshortin e ka të pa punë dhe pa pension. Znj.Diana Muçaj është punonjëse në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar, paguhet me pagë minimale.Këto të ardhura nuk mjaftojnë për të përballuar shpenzimet e terapisë.

E ndodhur në këto kushte të vështira ekonomike për Znj .Diana Muçaj Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasen Diana Muçaj.

**Përgjegjëse e NE dhe PAK-së
Teuta Hysenbelliu**

